

FUNKSIONI 9: ARSIMI

Programi 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Vështrim i përgjithshëm i programit

Programi mbulon arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur lokalet shkollore dhe duke paguar rrogat e stafit mbështetës.

09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtim dhe mirëmbajtje strukturave shkollore• Mbulim i pagave për stafin mbështetës
-------	-------------------------------	---



Qëllimi i politikës	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikatori	Situata 2019	Situata 2020	Situata e synuar 2021	Situata e synuar 2022	Situata e synuar 2023
Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm;	O1 Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të pershtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm të përgjithshëm	Përmirësimi i shërbimit në procesin edukativ dhe mësimor -nr i punonjësve mbështetës në arsimin e mesëm të përgjithshëm	51	43	43	43	43
		Numri i shkollave të mesme të përgjithshme	13	13	13	13	13
		Nr i shkollave që ngrohen me dru zjarri	4	6	7	7	7
		Nr i shkollave që ngrohen me gaz	9	5	2	1	1
		Nr i shkollave që ngrohen me kaldaja me naftë	4	4	5	5	5
		Nr i shkollave që do të nderhyhet	4	4	4	4	4
		Nr. objekteve të siguruara për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete	8	9	10	11	12
	- Nr i shkollave që kanë shërbimin e ruajtjes	0	13	13	13	13	
	Mbështetje për të rinjtë me bursë financiare: Nr i nxenesve që perfitojnë	82	7	7	7	7	
	O2 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.	Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm - Shkolla në të cilat janë kryer punime kundrejt numrit total të shkollave të mesme të përgjithshme në qytet	33%	33%	15%	0%	0%

		- Shkolla në të cilat janë kryer punime kundrejt numrit total të shkollave të mesme të përgjithshme në njësi administrative	-	42%	28%	14%	14%
		Efiçienca buxhetore për përmirësimin e shërbimit arsimor të mesëm - Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit të mesëm të përgjithshëm kundrejt numrit total të nxenesve të arsimit të mesëm të përgjithshëm (mijë leke/nxenes)	14.32	28.95	17.72	11.72	15.18

Të dhënat e programit / Vitet	2019	2020	2021	2022	2023
Nr punonjeshish i Mesem pergjithshem	43 punonjes mbeshtetes, zevendesues 8	43	43	43	43
Nr i shkollave te mesme te pergjithshme qytet	6	6	6	6	6
Nr i shkollave te mesme te pergjithshme NJA	7	7	7	7	7
Nr i shkollave qe ngrohen me dru zjarri	4 shkollla ne NJA	6 shkollla ne NJA	7 shkollla ne NJA	7 shkollla ne NJA	
Nr i shkollave qe ngrohen me gaz	9 shkollla	5 shkollla qytet, 1 NjA	6 shkollla qytet,	6 shkollla qytet,	
Nr i shkollave qe ngrohen me kaldaja me naftë	4 shkollla te mesme	4 shkolle te mesme	5 shkolle te mesme	5 shkolle te mesme	5 shkolle te mesme
Nr i shkollla ve qe do te nderhyhet	2 shkollla ne qytete2 shkollla ne NjA	4 shkollla ne qytete 6 shkollla ne NjA	2 shkollla ne qytete2 shkollla ne NjA	2 shkollla ne qytete2 shkollla ne NjA	2 shkollla ne qytete2 shkollla ne NjA
Nr. objekteve të siguruar për raste të ngjarjeve të jashtezakonëshme si zjarr dhe	6 qytet/2 ne NjA	7 qytet/2 ne NjA	7 qytet/2 ne NjA	9 qytet/2 ne NjA	9 qytet/2 ne NjA
- Nr i shkollave qe kanë shërbimin e ruajtjes	0	7 Shkollla qytet 6 NjA	7 Shkollla qytet 6 NjA	7 Shkollla qytet 6 NjA	7 Shkollla qytet 6 NjA
Nr i shkolave qe do te rikonstruktohet - Raporti i shpenzimeve operative për mirëmbajtjen dhe investimet në institucionin e arsimit të mesëm të përgjithshëm (mijë leke/institucion)	1 shkolle qytet, 4634 m2 , 23 klasa. 689 nxenes	1 shkolle qytet, 4634 m2 , 23 klasa. 689 nxenes	1 shkolle qytet, 4634 m2 , 23 klasa. 689 nxenes		
					1 shkolle NjA, 484 nxenes
					1 shkolle qytet, 13 klasa, 442 nxenes
Nr i nxenesve	3355	3355	3355	3355	3355
Shpenzimet buxhetore ne mije leke	48033	97140	59451	39328	50937

Projekte të rëndësishme				
Kodi projektit	Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit	Buxheti 2021 Mijë/lekë	Buxheti 2022 Mijë/lekë	Buxheti 2023 Mijë/lekë
P09230.O1.A1	Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm	25,684	25,684	25,684
P09230.O1.A2.	Mbështetje për infrastrukture dhe shërbimet mbështetëse	4,958	2,958	4,958
P09230.O1.A3.	Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	3,500	3,500	3,500
P09230.O1.A4.	Ngrohje me gaz të lengshëm për arsimin e mesëm të përgjithshëm	1,000	1,000	1,000
P09230.O1.A5.	Ngrohje me lende djegëse, karburant (naftë), për arsimin e mesëm të përgjithshëm	65	65	65
P09230.O1.A6.	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm	537	537	537
P09230.O1.A7	Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe termete për arsimin e mesëm të përgjithshëm	280	280	280
P09230.O1.A8.	Shërbim i sigurisë në objekte	3,004	3,004	3,004
P09230.O1.A9.	Transferim i kuotes financiare bursa për arsimin e mesëm të përgjithshëm	2,300	2,300	2,300
P09230.O2.A1.	Rikonstruksion Shkolla "Jordan Misja" Faza I (Investim në proces nga viti 2020)	287	-	-
P09230.O2.A2.	Rikonstruksion Shkolla "Jordan Misja" Faza II	18,123		
P09230.O2.A3.	Ndërtim fushe me sistemim oborri Shkolles mesme bashkuar "Adem Haxhija"	-	-	4,811
P09230.O2.A4.	Rikonstruksion shkolla "Kol Idromeno"	-	-	4,798

Informacion financiar						
Vitet	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Tavani i përgjithshëm i programit				59,738	39,328	50,937
Shpenzimet bruto	100,590	48,033	84,567	59,738	39,328	50,937
Të ardhurat e programit	63,802	25,734	30,440	35,780	26,489	26,489
Shpenzimet neto	36,788	22,299	54,127	23,958	12,839	24,448
Pagat dhe sigurimet shoqërore				25,684	25,684	25,684
Investimet kapitale				20,410	-	11,609

Komente

Programi 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem, ka si burim financimi kryesisht te ardhurat qe vijne nga transferta pakushtezuar sektoriale, transferta e kushtezuar per pagesen e nxenesve bursiste dhe trashegimi me destinacion. Ndersa shpenzimet neto jane shpenzime qe mbulohen nga te ardhurat dhe transferta e pakushtezuar me nje mesatare prej 44.62%. Pjesën me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore me rreth 43% ne vitin 2021, 65.3% ne vitin 2022 dhe 50.4 % ne vitin 2023. Ndersa shpenzimet korrente zene 22.8% ne vitin 2021, 34.7% ne vitin 2022 dhe 26.8% ne vitin 2023. Shpenzimet kapitale zene 34.2% ne vitin 2021, 0% ne vitin 2022 dhe 22.8% ne vitin 2023.

Nr.1	P09230.O1.A1. Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni.9ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim i mesëm i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Bashkia e Shkodrës siguron mirëfunksionimin e një numri të madh institucionesh që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", shkresën nr.11166, datë 24.12.2015, në lidhje me procedurat e transferimit të punonjësve si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria e Arsimit e Sportit tek Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) si dhe në transfertë specifike parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit, llogaritja e pagave për vitin 2020 është mbi bazën e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.33 datë 28.02.2019, dhe 06/8 datë 16.07.2019 "Për miratimin e strukturës së Administratës dhe të institucioneve të Varësisë të Bashkisë Shkodër për vitin 2019". Planifikimi i pagave është planifikuar me ndryshimin e Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 809 Date 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" Bashkia Shkodër mbështet paga dhe sigurime shoqërore shërbimit në arsimin e mesëm, paga dhe sigurime për 43 punonjës staf mbështetës.						
ii. Synimi i projektit						
Mbështetje e stafëve të shkollave në Bashkinë Shkodër për të gjithë personelin mbështetës.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Kryerje e rregullt e pagesave për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësorë të punonjësve, në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparence.						
b) Rezultatet që prisni						
Çdopunonjës sipas pozicionit të punës të shërbejë, të japë rezultate pozitive duke zbatuar ligjin, vendimet e bashkisë dhe urdhrat e titullarit të institucionit.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Stafi			Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzime të llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	43 punonjësmbështetës në Arsimin e mesëm të përgjithshëm	25684	22160	3524		
	Shuma	25684	22160	3524		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	43 punonjësmbështetës në Arsimin e mesëm të përgjithshëm	25684	22160	3524		
	Shuma	25684	22160	3524		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	43 punonjësmbështetës në Arsimin e mesëm të përgjithshëm	25684	22160	3524		
	Shuma	25684	22160	3524		

f) Periudha e zbatimit
2021,2022,2023

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:Drejtoria
Ekonomike Arsimit, Bashkia Shkoder
Institucioni likuidues:Drejtoria Ekonomike Arsimit



Nr.2	P09230.O1.A2 Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse	Funksioni.9ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim mesem i përgjithshëm
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i.Situata		
<p>Në sistemin arsimor të mesem të përgjithshëm të Bashkisë Shkoder funksionojnë 13 shkolla nga të cilat 6 shkolla të mesme në qytet dhe 7 shkolla të mesme në njësite administrative, me një nr. xxënësish rreth 3 355.</p> <p>Për administrimin e funksionimit të shkollave të arsimit të mesem të përgjithshëm kërkohet mbështetja dhe financimi për shërbimet dhe mirëmbajtjen:</p> <p>Materiale kancelarie Materiale të ndryshme mbështetëse Materiale hidraulike Materiale për pastrimi për ambientet Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe orendi Shërbim i energjisë elektrike. Shërbim me ujë të pijshëm Materiale tëndryshme mbështetëse (xham,bojëra) Materiale elektrike Pajisje dhe orendi për arsimin Pajisje teknike operacionale Blerje pajisje sistemi sigurimit Shërbim Interneti</p> <p>Për krijimin e kushteve sa më të favorshme të nxënësve që mësojnë në shkolla të mesme të përgjithshme të Bashkisë Shkoder, kemi parashikuar blerjen e materialeve mbështetëse në shërbim të tyre, kemi parashikuar blerjen e materialeve mbështetëse të mjeteve të kancelarisë për të gjitha shkollat e mesme e të përgjithshme. Për çdo vit është bërë blerja dhe shpërndarja në bazë të një grafiku të materialeve të kancelarisë. Furnizim me këto materiale është parashikuar të bëhet përveç shkollave të mesme të përgjithshme të qytetit edhe të atyre të njësite administrative duke ruajtur si kriter kapacitetet e shkollave që na dërgohen zyrtarisht nga Drejtoria Rajonale Arsimore.</p> <p>Gjatë gjithë vitit Bashkia Shkoder punon për ndërhyrjet dhe riparimet në shkolla, kjo për krijimin e kushteve sa më të favorshme në procesin edukativo-mësimor. Për realizimin e ndërhyrjeve është e nevojshme të parashikohen materiale si:</p> <p>Brava dyer druri, reflektor gaz (për shkollat në qytet dhe në njësitë administrative kryesisht, konviktin e shkollës Industriale dhe për pak shkolla të qytetit) dryj, tuba dhe kthesa shporetit me dru, mjete punë të ndryshme (sharra, lopata, kazma, pinca, çekiçë, traponë. etj) dhe një shume rezerve për probleme të paparashikuara të blerjeve nga shkollat dhe konviktet si furnela gatimi, rafte metalike, pajisje të ndryshme për riparim soba dhe reflektorëve me gaz, kërkesa të tjera për tuba kthesa të shporeteve, brava të modeleve të ndryshme për dyer duralumini, etj.</p> <p>Për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore janë vlerësuar kërkesat e paraqitura nga shkollat e njësite administrative dhe atyre në qytet. Nisur nga problemet e paraqitura janë parashikuar këto materiale hidraulike: Pompa uji copë, rubinete, problem që shfaqet vazhdimisht në shkolla nga dëmtimet e nxënësve, mishilatorë të ndryshëm, shkarkues banjo, tuba të ndryshëm fleksibel (element që konsumohet nga të gjitha shkollat), vegla punë (çelës hidraulik, pince hidraulike) për shkollat. Lavamanë dhe WC që thyhen, shkarkues ujit nëbanjo, rubinete të natyrave të ndryshme, pjesë ndërrimi për pompa uji dhe pompa që digjen nga përdorimi kur mungon ujë në rrjet, tuba të ndryshëm fleksibel .</p> <p>Për të krijuar një situatë sa më normale të kushteve higjienikë kemi vlerësuar nevojën e atyre materialeve që do mundësojnë mbajtjen në kushte higjienikë normale ambientet shkollorë. Në përpilimin e shpenzimeve për materiale pastrimi është marrë parasysh numri i fëmijëve dhe i klasave për çdo shkollë,</p> <p>Pjesë e ndërhyrjeve në shkolla është dhe riparim i pajisjeve dhe orendive, (karrige e tryeza nxënësish) nisur nga gjendja e prezantuar prej drejtorive të shkollave. Kjo ndërhyrje është e nevojshme edhe për të ulur shpenzimet për blerje të pajisjeve (orendi) për institucionet ku janë paraqitur kërkesa të konsiderueshme. Shërbimi është parashikuar për institucionet arsimore të njësite administrative si dhe në qytet.</p> <p>Është bërë planifikimi për energjinë elektrike të konsumit për 13 shkolla nga të cilat 6 shkolla të mesme në qytet dhe 7 shkolla të mesme në njësite Administrative.</p> <p>Gjithashtu për ndërhyrjet dhe riparimet në shkolla, kjo për krijimin e kushteve sa më të favorshme në procesin edukativo-mësimor. Për realizimin e ndërhyrjeve është e nevojshme të parashikohen materiale elektrike si: lapa të thjeshta, neon, portollampa e aksesor të tjerë të nevojshëm për përmirësimin e kushteve në ambientet e shkollave.</p> <p>Bashkia e Shkodrës duhet të sigurojë mirëfunksionimin e një numri të madh institucioneve arsimore që kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe në pajisjen e tyre me orendi për mobilimin e klasave. Këto orendi janë tryeza dhe karrige nxënësish, tryeza dhe karrige mësuesish, rafte etj.</p> <p>Për vitin 2020 në përmbushje të kërkesave të domosdoshme që janë paraqitur blerjet për pajisje janë parashikuar :</p> <p>Stufa për ngrohje me dru zjarri për të plotësuar kërkesat me të domosdoshme të institucioneve arsimore.. Gjithashtu kërkesat për pajisje orendi për zyrat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit (kompjuter, fotokopje printer, si dhe kamera të sigurisë), kërkesa nga shkollat për tu pajisur me kamera në ambientet shkollorë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Përmirësimi i shërbimit në shkollat e mesme të përgjithshme nxënësit mësim i nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit		

Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në shkolla Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; Realizimi i procedurave të prokurimit; Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; Monitorim dhe raportim i aktiviteteve mujor për realizimin e projektit;						
b) Rezultatet që prisni						
Plotësimin e të gjitha shërbimeve për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha shkollat e sistemit arsimor të mesëm të përgjithshëm. Nxënësit në shkollat e mesme të Bashkisë Shkoder të kenë kushte sa më të favorshme gjatë qëndrimit dhe ndjekjes së procesit mësimor.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Nxënësit, mësuesit			Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A1	Blerje materiale kancelarie	485			485	
A2	Blerje material të ndryshme	270			270	
A3	Blerje materiale hidraulike	350			350	
A4	Blerje materiale pastrimi	570			570	
A5	Riparim pajisje orendi	23			23	
A6	Furnizim me energji ujë	600			600	
A7	Certifikim i kaldajave	50			50	
A8	Blerje bojërash	260			260	
A9	Blerje materiale elektrike	200			200	
A10	Kalibrimi i kaldajave	50			50	
A11	Riparime të ndryshme	50			50	
A12	Blerje pajisje sistemi sigurimit	400				400
A 13	Blerje pajisje operacionale	100				100
A 14	Blerje pajisje për mobilim	1500				1500
A15	Shërbim Interneti	50			50	
Shuma		4958			2958	2000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse	2958			2958	
Shuma		2958			2958	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse	4958			2958	2000
Shuma		4958			2958	2000
f) Periudha e zbatimit vitit 2021, 2022, 2023			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit, Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit			

Nr.3	P09230.O1.A3 Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni.9ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim mesem i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
<p>Bashkia Shkoder, nder shërbimet që ajo ofron dhe mbështet shkollat e mesme është dhe shërbimi i ngrohjes me dru zjarri. Për krijimin e kushteve sa me të favorshme të nxënësve që mësojnë në shkollat e Bashkisë Shkoder, kemi parashikuar blerjen e lendes dru zjarri për ngrohje për 6 shkollat të arsimit të mesëm të përgjithshëm në Njësiti Administrative. Shkolla e mesme "Adem Haxhija" NjA Postribë dhe Shkolla e mesme "Lucë Agraja" NjA Dajç. Gjinnazi "Oblike" NjA Ana Malit, Shkolla "Nikolle Zagorjani" NjA Velipoje, Shkolla "At Gjon Karma" NjA Gur i Zi, Shkolla "Mehmet Shpendi" NjA Shale. Shkolla Frederik Gjoni NjA Bërdice.</p> <p>Përfitues të këtij shërbimi janë 642 nxënës. Sasia e parashikuar është bërë mbi bazën e një kuotë mujore që shkon mesatarisht 0.7-0.8-1m3 në muaj për një ambient/klasë</p>						
ii. Synimi i projektit						
Sigurimi i shërbimit të ngrohjes në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm plotësim i nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në shkolla Përgatitja e specifikime veteknike për mallra dhe shërbime; Realizimi i procedurave të prokurimit; Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; Monitorim dhe raportim i aktivitetit mujor për realizimin e projektit;						
b) Rezultatet që prisni						
Sigurimi i shërbimit të ngrohjes në dru zjarri për krijimin e kushteve të përshtatshme në shkollat 9-vjeçare. Nxënësit në shkollat e Bashkisë Shkoder të kenë kushte sa me të favorshme gjate qëndrimit dhe ndjekjes se procesit mësimor.						
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt				
Nxënësit,mësuesit		Bashkia e Shkodrës				
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Blerje dru zjarri	3500			3500	
Shuma		3500			3500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Blerje dru zjarri	3500			3500	
Shuma		3500			3500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali(mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Blerje dru zjarri	3500			3500	
Shuma		3500			3500	
f)Periudha e zbatimit vitit 2021,2022,2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit, BashkiaShkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit				

Nr.4	P09230.O1.A4 Ngrohje me gaz të lëngshëm për arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni.9ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim mesem i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
<p>Bashkia Shkoder, nder shërbimet që ja ofron dhe mbështet shkollat është dhe shërbimi i ngrohjes me gaz të lëngshëm. Për krijimin e kushteve sa më të favorshme të nxënësve që mësojnë në shkollat e mesme të Bashkisë Shkoder, kemi parashikuar blerjen e gazit të lëngshëm për ngrohje. Do të furnizohen 2 shkolla të mesme profesionale, 2 shkolla të mesme në qytet.</p> <p>Shkolla të mesme në qytet Shkolla "Jordan Misja" Shkolla "Kole Idromeno"</p> <p>Shkolla të mesme profesionale Shkolla "Arben Broci" Shkolla "Kole Margjini"</p> <p>Nisur nga këto të dhëna nga ZVA Shkoder për numrin e klasave, janë parashikuar shpenzimet për konsum gazi,për ngrohje. Sasia e llogaritur është bazuar në një konsum mujor për çdo ambjent mësimor, me 15 kg (një bombol gazi) për 4 muaj në vit.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Ofrimi i shërbimit të ngrohjes me gaz në shkollat e mesme të përgjithshme plotësim i nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në shkolla Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; Realizimi i procedurave të prokurimit; Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; Monitorim dhe raportim i aktivitetit mujor për realizimin e projektit;						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimin e të gjitha shërbimeve për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha shkollat e mesme të përgjithshme Nxënësit në shkollat e Bashkisë Shkoder të kenë kushte sa më të favorshme gjate qëndrimit dhe ndjekjes se procesit mësimor.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Nxënësit, mësuesit				Bashkia e Shkodrës		
e)Shpenzime te llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali(mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Blerje gaz i lëngshëm për ngrohje për sistemin e mesem të përgjithshëm..	1000			1000	
Shuma		1000			1000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali(mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Blerje gaz i lëngshëm për ngrohje për sistemin e mesem të përgjithshëm.	1000			1000	
Shuma		1000			1000	
Shpenzimet për çdoaktivitet 2023		Totali	Ngakjo:			

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Blerje gaz i lëngshëm për ngrohje për sistemin e mesem të përgjithshëm..	1000			1000		
	Shuma	1000			1000		
f) Periudha e zbatimit vitit 2021,2022,2023			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit, Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit				



Nr.5	P09230.O1.A5 Ngrohje me lende djegëse, karburant (naftë), për arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit:09230. Arsimmesem i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
Burimi tjetër alternativ që Bashkia Shkoder ofron shërbimin e ngrohjes është ai me naftë për kaldajat. Bashkia Shkoder ofron shërbimin e ngrohjes nëpërmjet sistemit të kaldajës për 4 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm. Nga të cilat 4 shkolla në qytet. Përfitues janë 1768 nxënës , Shkolla e mesme Oso Kuka me rreth 618 nxënës , Shkolla e Mesme 28 Nëntori me rreth 600 nxënës, Shkolla e Mesme Shejnaze Juka me rreth 410 nxënës, Shkolla e Mesme Prenk Jakova me rreth 140 nxënës, Për institucionet e cituara me sipër, pwr llogaritjen e planifikimit, është marre në konsideratë konsumi orar i kaldajave dhe gjithashtu koha e domosdoshme për ngrohje 3-4 ore në ditë të shkollave për periudhën 4muajore.						
ii. Synimi i projektit						
Ofrimi i shërbimit të ngrohjes me kaldaja në shkolla plotësim i nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit						
iii.Aktivitetet kryesoretë projektit						
Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në shkolla Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; Realizimi i procedurave të prokurimit; Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; Monitorim dhe raportim i aktivitetit muajor për realizimin e projektit;						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimin i shërbimit të ngrohjes me kaldaje për krijimin e kushteve të përshtatshme në shkolla. Nxënësit në shkollat e Bashkisë Shkoder të kenë kushte sa më të favorshme gjate qëndrimit dhe ndjekjes së procesit mësimor.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Nxënësit, mësuesit				Bashkia e Shkodrës		
e) Shpenzime të llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Total i (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime kapitale
A.1	Blerje lende djegëse karburant për sistemin e mesëm të përgjithshëm.	65			65	
Shuma		65			65	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Total i (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime kapitale
A.1	Blerje lende djegëse karburant për sistemin e mesëm të përgjithshëm.	65			65	
Shuma		65			65	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Total i (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime kapitale
A.1	Blerje lende djegëse karburant për sistemin e mesëm të përgjithshëm.	65			65	
Shuma		65			65	
f) Periudha e zbatimit vitit 2021, 2022, 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit, Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit				

Nr.6	P09230.O1.A6 Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni.9ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim mesem i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
<p>Bashkia Shkoder çdo vit bën ndërhyrje dhe mirëmbajtje në shkolla. Rregullimi dhe riparimi i ambienteve shkollore, për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore janë vlerësuar kërkesat e paraqitura nga shkollat e njësite administrative dhe atyre në qytet. Mirëmbajtja e ambienteve shkollore, për të krijuar kushte normalenë institucionet arsimore janë vlerësuar kërkesat e paraqitura nga dëgjesa publike për shkollat e njësite administrative dhe atyre në qytete. Për vitin 2020 është menduar për të ndërhyre në ato objektet që kanë nevojën me të madhe dhe nr. me të konsiderueshme të nxënësve.</p> <p>Kështu sipas analizës së situatës aktuale nevojat paraqiten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Shkolla "Shejnaze Juka" paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes nga prania e lagështirës në disa ambiente në kat përdhe dhe dëmtimet të hidrosanitare . ✓ Shkolla "Frederik Gjoni", paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes në çatinë e shkollës. ✓ Shkolla "Prenk Jakova" paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes për rikonstruksionin e terracës. ✓ Shkolla " At Gjon Karma" paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes e dyer dhe dritare. ✓ Shkolla "Luce Agraja" paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes për rehabilitimin e katit përdhe të godinës. ✓ Gjimnazi "Oblike" paraqitet nevoja për punime të mirëmbajtjes për zëvendësimin e ulluqeve. ✓ Shkolla Oso Kuka paraqet nevojën e vendosjes se rrjetës rethuese tek ambientet sportive. ✓ Shkolla Jordan Misja paraqet nevojën e zëvendësimit te pompes se ujit per te shtuar kapacitetin e furnizimit me uje te shkollës. ¹ <p>Gjatë tre viteve të fundit është punuar kryesisht për përmirësimin e ambienteve brenda shkollave më synim së pari reduktimin e rrezikut që në shumë raste ka qenë i madh, në objektet shkollore mësimore. E nga ana tjetër më pas kemi punuar për rritjen e standardit të ambienteve të edukimit, duke balancuar sidomos kushtet në shkollat në qytet me ato në fshat. Tashmë po punojmë për përmirësimin e ambienteve të jashtme në institucionet arsimore. Kemi nisur punën në vitin 2019 dhe do të vazhdojmë punën për përmirësimin.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<p>Inspektim rutine në objektet arsimore në varësi të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit vlerësimi i situatës në çdo objekt që do kërkojë ndërhyrje dhe konceptimi i një ndërhyrje sa më të përshtatshme, Ndjekja hap pas hapi nga afër e punimeve deri në përfundimin e tyre, me rezultatet e pritura. Përgatitja e plotë e dosjes së prokurimit, me preventivin, specifikimet teknike dhe grafikun e punimeve, fondin limit Zbatimi i punimeve. Ndjekje dhe marrja në dorëzim punimeve të realizuara sipas situacionit dhe verifikimit në vend.</p>						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
<p>Objektet arsimore janë të riparuar në kohe dhe në cilësinë e duhur për një proces mësimor të rregullt dhe brenda kushteve teknike, duke krijuar mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor në kushte me dinjitarë për nxënësit dhe stafin. Shkollat dhe ambientet e jashtme janë të sigurta. Kushtet e higjienës dhe të shërbimeve janë përmirësuar.</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<p>Rregullimi dhe riparimi në objektet arsimore janë të riparuar në kohe dhe në cilësinë e duhur për një proces mësimor të rregullt dhe brenda kushteve teknike, si dhe mundësia e zhvillimit të procesit mësimor në kushte me dinjitarë për nxënësit dhe stafin.</p> <p>Ruajtja e objekteve arsimore nga amortizimet e mëtejshme e cilado kishte dhe një kosto me të madhe financiare për institucionin tone.</p> <p>Ruajtja e sigurisë dhe shëndetit të nxënësve dhe stafit mësimdhënës në këto objekte</p>						
c) Aktorët emundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Nxënësit e shkollave Stafi mësimdhënës dhe komunitet e zonave përkatëse			Bashkia e Shkodrës			
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet përçdo aktivitet 2021		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit të mesem	537			537	

¹ Kërkesa të Këshillit Bashkiak, propozuar në mbledhjen e Komisionit të Arsimit me datën 17.12.2020 ne kuader te shqyrtimit te projektbuxhetit te vitit 2021 dhe PBA 2021-2023.

	Shuma	537			537		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022	Totali (mijë lekë)	537	Ngakjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit të mesëm	537			537		
	Shuma	537			537		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali (mijë lekë)	537	Ngakjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve të arsimit të mesëm	537			537		
	Shuma	537			537		
f) Periudha e zbatimit vitit 2021,2022,2023			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit, BashkiaShkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit				



Nr.7	P09230.O1.A7 Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete për arsimin e mesëm të përgjithshëm	Funksioni.9 ARSIMI N/Funksioni:P092. Arsimi parauniversitar. Llojet e programit: 09230. Arsim mesem i përgjithshëm				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
<p>Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithëfëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare.</p> <p>Bashkia e Shkodrës duhet të sigurojë mirë funksionimin e një numri të madh institucionesh që kërkojnë një vëmendje të veçantë bazuar në ligjin Nr.139/2015 "PËRVETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 23, Funksione të bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.</p> <p>ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit Nr.30 Datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik "kreu IV, pika 74, i ndryshuar;</p> <p>Çdo vit është planifikuar për të bërë sigurimin e objekteve, për shkollat që janë me numër më të madh nxënësish. Sigurimi i objekteve është bërë për raste ngjarje të jashtëzakonshme si për zjarr dhe tërmete, Synohet që të kemi parashikuar sigurimin që për çdo ngjarje të jashtëzakonshme të përfitojnë këtë shërbim shkollat e mesme "Koleldromeno", "Teknologjike", "28Nëntori", "JordanMisja", "Oso Kuka",</p>						
ii. Synimi i projektit						
Sigurimin që për çdo ngjarje të jashtëzakonshme të përfitojnë këtë shërbim						
iii.Aktivitetet kryesoretë projektit						
Marrjen e kërkesave për secilin institucion. Vlerësim i kërkesave në përputhje me kapacitetet Kryerja e procedurave përkatëse. Monitorimi i procesit						
b) Rezultatet që prisni						
Krijimi kushteve optimale të punës për mësuesit dhe nxënësit gjatë procesit mësimor						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Nxënësit e shkollave Stafi mësimdhënës dhe komunitet të zonave përkatëse				Bashkia e Shkodrës		
e)Shpenzimetellogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali(mijëlekë)	Ngakjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Sigurimi i objekteve të sistemit të mesem të përgjithshëm për rastet e ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete.	280			280	
Shuma		280			280	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali(mijëlekë)	Ngakjo:			
